



**REPUBLIKA E KOSOVES**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA**  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA**

---

**AD/GJTHPR/06/24**

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga L.A ndaj gjyqtarit R.G, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 08.04.2024 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga L.A ndaj gjyqtarit R.G, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

Parashtruesi i ankesës L.A me datë 16 Mars 2024 ka paraqitur ankesë disiplinore në institucionin e Avokatit të Popullit kundër gjyqtarit R.G. Për shkak të kompetencës, me datë 25 Mars 2024 ankesa është përcjellë nga Institucioni i Avokatit të Popullit në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për trajtim dhe vendosje. Në lidhje me pranimin e ankesës, me datë 27 Mars 2024 është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Parashtruesi i ankesës L.A ka paraqitur ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit R.G për shkak të mos zbatimit të dispozitave ligjore (shkeljes së ligjit), për shkak të mos respektimit të parimit të pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore si dhe për shkak të shkeljeve të detyrave zyrtare si gjyqtar. Sipas tij, me aktgjykimin A.nr.1269/23 të datës 07.03.2024 gjyqtari i çështjes nuk ka zbatuar dispozitat ligjore si dhe nuk ka vlerësuar diç duhet provat të cilat janë të sakta dhe të pakontestueshme. Sipas tij me datë 13.05.2023 ka marrë pjesë në provimin e jurisprudencës me kod 052023-665 nga e drejta penale dhe me datën 14.05.2023 ka marrë pjesë në provimin nga e drejta civile, ku sipas tij detyrat i ka zgjedhur me aktgjykim dhe në bazë të rregullave ligjore në fuqi, por nuk ka qenë pjesë e listës përfundimtare si kandidat i suksesshëm. Tutje i njëjti ka deklaruar se ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit me ç rast komisioni për dhënien e provimit të jurisprudencës ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim. Tutje ka vazhduar me deklaratën se detyra me shkrim në të drejtën penale ka qenë rast gjyqësor i vërtetë i Gjykatës Themelore në Pejë me numër PKR.nnr.117/21 i datës 17.12.2021 e që është në kundërshtim me udhëzimin administrativ MD nr. 06/22, ku parashihet se provimin me shkrim e përpilon anëtari i komisionit, e që në rastin konkret ka qenë aktgjykim i marrë nga gjykata. Sipas tij, gjyqtari i çështjes ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që në detyrat e zgjidhura nga i njëjti shihet se janë aplikuar ligjet në fuqi dhe janë të gjitha elementet si caktimi i kompetencës, hyrja, dispozitivi, arsyetimi, udhëzimi juridik, nënshkrimi i gjyqtarit etj. Tutje ka deklaruar se me datën 07.07.2023 ka ushtruar padi dhe me datën 20.11.2023 përmes e-mail-it zyrtar i është drejtuar zyrës për komunikim publik dhe media më ç rast ka kërkuar që të informohet në lidhje me lëndën, ku me datë 22.11.2023 ka marrë një përgjigje në lidhje me informimin që gjyqtari e ka dhënë ku është theksuar se

me datë 07.07.2023 është pranuar padia dhe me datën 15.08.2023 është nxjerrë aktvendim për përgjigje në padi, ku edhe pse me datën 25.08.2023 është pranuar ky aktvendim nga e paditura e njëjta nuk është përgjigjur në afat prej 30 dite, por me datën 21.11.2023 ju është dhënë edhe një afat i dytë për përgjigje në padi prej 10 dite, ku sipas tij këto mund të shihen nga biseda e zhvilluar në mes tij dhe zyrtares për komunikim publik dhe media. Sipas tij, meqenëse pala e paditur nuk është përgjigjur, është bërë shkelja e Ligjit nr. 03/L-202 për Konflikt Administrativ, përkatësisht neni 27 par. 2, ku përgjigja jepet në afat prej 30 dite nga dita e dorëzimit të padisë palës, nëse pala e paditur edhe pas kërkesës së dytë nuk përgjigjet dhe nuk i dërgon shkresat e lëndëve, a po nëse deklaroi se nuk mund ti dërgojë, gjykata do të vendos për çështjen edhe pa shkresat e lëndës. Sipas tij, këtë e mbështet pasi që është informuar se pala e paditur nuk i është përgjigjur gjykatës, ku këtë gjë e ka kuptuar pas kërkesës për qasje në dokumente publike të cilën e ka parashtruar me datë 04.01.2024. Ndër të tjera ka deklaruar se Ministria e Drejtësisë përmes Avokaturës Shtetërore ka bërë përgjigje në padi jashtë afatit ligjor dhe të gjitha këto shkelje janë mbuluar nga gjyqtari R.G, duke nxjerrë aktgjykim në kundërshtim me dispozitat ligjore. Në fund ka kërkuar që të njëjtit t'i shqiptohen masat më të rënda pasi i njëjti këto veprime i ka kryer me paramendim, duke e favorizuar palën e paditur.

Në lidhje me pretendimet e paraqitësit të ankesës, gjyqtari i çështjes ka deklaruar se me datë 07.07.2023 në gjykatë është parashtruar padia e paditësit L.A kundër të paditurës Ministria e Drejtësisë-Komisioni për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulimin e vendimit me nr. protokollit 422-712 i datës 29.05.2023. Me datë 15.08.2023 i njëjti si gjyqtar i çështjes ka nxjerr aktvendimin për përgjigje në padi i cili i është dërguar të paditurës. Me datë 21.11.2023 ka pranuar një email nga zyrtarja për informim e gjykatës M.G, ku paditësi ka kërkuar të informohet lidhur me lëndën dhe që e njëjta të trajtohet nga gjykata më shpejt, pasi ka të bëjë me provim të jurisprudencës. Tutje ka deklaruar se përmes emailit e ka njoftuar zyrtaren e informimit të gjykatës se gjykata me datë 15.08.2023 ka nxjerr aktvendimin për përgjigje në padi në këtë lëndë, mirëpo përfaqësuesja ligjore e të paditurës Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore edhe pse e ka pranuar aktvendimin e gjykatës me datë 25.08.2023, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afati prej 30 ditësh. Gjykata duke vepruar sipas nenit 37.3 të LKA-së me datë 21.11.2023, për herën e dytë i ka kërkuar të paditurës shkresat e lëndës brenda afatit prej 10 ditësh. Gjithashtu e ka njoftuar të njëjtën se bazuar në Planin Strategjik të Përmirësimit të Qasjes në Drejtësi të KGJK-së 2022-2025 të datës 08.06.2022, lëndët e kësaj natyre nuk janë radhitur tek lëndët me prioritet, mirëpo gjykata e ka parasysh faktin se kjo lëndë ka të bëjë me provimin e jurisprudencës dhe në momentin që do të plotësohen kushtet ligjore do të shikoj mundësinë e caktimit të seancës gjyqësore dhe do ti ftoj palët ndërgjyqëse. Gjykata për datën 21.02.2024 me fillim në ora 11:00, ka caktuar seancën gjyqësore ku ka ftuar palët ndërgjyqëse. Në seancë ka prezantuar paditësi personalisht dhe e autorizuar e tij avokate Arlinda Haziri ndërsa nuk ka prezantuar askush nga përfaqësuesja ligjore e të paditurës Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore, e cila përmes emailit të datës 21.02.2024 kishte kërkuar shtyrjen e seancës me arsyetimin se avokatet shtetërore gjenden në trajnim, mirëpo gjykata me aktvendim e ka refuzuar shtyrjen e seancës dhe e ka mbajtur seancën gjyqësore në kuptim të nenit 41 të LKA-së. Tutje me aktgjykimin A.nr.1269/2023 të datës 21.02.2024, është refuzuar kërkesëpadija e paditësit si e pa bazuar, aktgjykim të cilin palët e kanë pranuar me datë 12.03.2024 nga gjykata.

Tutje i njëjti ka deklaruar se sa i përket pretendimeve ankimore të paditësit në raport me të si gjyqtar i çështjes janë në tërësi si të pa bazuara. Sipas tij, në lidhje me pretendimin e paditësit për shkeljen e dispozitave ligjore, gjyqtari i çështjes asnjë dispozitë ligjore nuk e ka shkelur në rastin konkret. Trajtimi i palëve në procedurë sipas tij ka qenë komfor të gjitha dispozitave ligjore në fuqi dhe në harmoni me Kodin e Etikës Profesional për Gjyqtar. Tutje gjyqtari ka deklaruar se i njëjti nuk ka pasur vërejtje në gjyqtarin e rastit kur është mbajtur seanca gjyqësore dhe procesverbalin e seancës gjyqësore e ka nënshkruar pa pasur asnjë vërejtje. Pretendimet e ankuesit në rastin konkret të paditësit për shkelje të ligjit material nga gjyqtari, në fakt siç shihet nga ankesa e tij kanë të bëjnë me vendimmarrjen e gjyqtarit

të çështjes, për të cilën paditësi ka të drejtë të paraqes ankesë në brenda afatit 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, mirëpo këto pretendime nuk paraqesin bazë për ankesë ndaj gjyqtari për shkelje disiplinore, sepse dihet që gjyqtari sa i përket vendimmarrjes ka imunitet funksional. Gjyqtari i çështjes ndër të tjera ka deklaruar se paditësi përmes të autorizuarës me datë 19.03.2024 ka parashtruar ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e Apelit, dhe siç shihet po thuajse të gjitha pretendimet në ankesë të parashtruar kundër aktgjykimit janë të njëjta me pretendimet e parashtruar ndaj gjyqtarit të çështjes. Sa i përket asaj se e paditura përmes Avokaturës Shtetërore ka paraqitur përgjigje në padi jashtë afatit prej 30 ditësh, gjykata thekson se bazuar në nenin 37 të LKA-së përgjigja në padi duhet të paraqitet brenda afatit prej 30 ditësh nga dorëzimi i padisë palës së paditur, dhe nëse e njëjta nuk paraqet përgjigje gjykata sipas paragrafi 3 të këtij neni parashtron kërkesë të dytë te pala e paditur për dorëzimin e shkresave të lëndës, siç ka vepruar në këtë rast me kërkesën e datës 21.11.2023 drejtuar përfaqësues ligjore të paditurës. Me datë 07.02.2024 pra para datës së mbajtje së seancës gjyqësore gjykata ka pranuar përgjigjen në padi nga Avokatura Shtetërore, një kopje të së cilës gjykata ja ka dorëzuar në seancë të autorizuarës së paditësit e për të cilën ajo është deklaruar edhe në seancë. Fakti se përgjigja në padi është paraqitur jashtë afatit nuk ka kurrfarë pasojë ligjore për të paditurën dhe se e njëjta vetëm është lexuar si deklarim në seancë në mungesë të avokaturës shtetërore. Pretendimet për mos respektim të parimit të pavarësisë dhe paanshmërisë si dhe shkeljeve të detyrave të gjyqtarit janë pretendime tërësisht të pa bazuara, të pa argumentuara me asnjë fakt të vetëm nga ankuesi. Gjyqtari i rasti thekson se Gjykata sipas nenit 43.1 të LKA vendos në konfliktin administrativ në bazë të fakteve të vërtetuar në procedurë administrative e jo në bazë të përgjigjes në padi. Aktgjykimi në këtë rast është nxjerr në harmoni me Ligjin për Konfliktet Administrative nr.03/L-202, respektivisht nenin 46 të tij. Në fund, i ka propozuar autoritetit kompetent që të refuzoj ankesën e paditësit L.A si të pa bazuar.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit R.G.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, për Autoritetin Kompetent ishte e rëndësishme gjetja e shkeljeve të cilat parashihen me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L – 057, të cilat janë: dënimi për një vepër penale; shkelja e ligjit, ose shkelja e detyrave të tij zyrtare si gjyqtar.

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë vlerëson se në rastin konkret pas shqyrtimit të dosjes dhe shkresave të lëndës nuk ka arritur të provojë pretendimet e palës ankuese për mos respektim të parimit të pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore, si dhe në këtë drejtim parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar prova për të argumentuar se si rezultat i cilave fakte ka arritur të konstatoj se gjyqtari ka shkelur pavarësinë e tij, a po është treguar i njëanshëm, a po çfarë sjellje është manifestuar nga gjyqtari i rastit e cila bie ndesh me Kodin e Etikës për gjyqtarë apo veprime të cilat hyjnë në domenin disiplinor.

Kjo sepse, i njëjti nuk ka paraqitur asnjë vërejtje në procesverbalin e seancës gjyqësore, i cili është i vetmi mjet në këtë rast që të vërtetohet nëse ka ndodhur ndonjë shkelje nga ana e gjyqtarit gjatë seancave gjyqësore.

Lidhur me pretendimin e parashtruesit se gjyqtari R.G nuk ka aprovuar padinë e paditësit dhe ka shkelur të drejtën materiale a po nuk ka bërë zbatim të duhur të dispozitave ligjore dhe rrjedhimisht me këto veprime gjyqtari është treguar i njëanshëm dhe ka shkelur detyrat e tij zyrtare si gjyqtar, Autoriteti Kompetent nuk është kompetent dhe nuk ka të drejtën e komentimit të vendimit të marrë nga gjykata përkatësisht nga gjyqtari i çështjes sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtarët veprojnë konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi. Në këtë drejtim, me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: “Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë,

mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë”, e po ashtu parimi i njëjtë mbrohet edhe nga instrumentet ndërkombëtare ku në Deklaratën Universale mbi Pavarësinë e Gjyqtareve, ku parashihet: "Gjykatësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre duhet të jenë të lirë për të vendosur mbi çështjet në mënyrë të paanshme, në përputhje me vlerësimin e tyre të lirë të fakteve dhe të kuptuarit e tyre të ligjit”.

Gjithashtu, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate rikujton parashtruesin se aplikimi i gabuar të së drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtareve gjatë punës së tyre, mund të jetë shkak për ushtrimin mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme në gjykatat e instancave më të larta nga pala e pakënaqur qoftë ndaj aktvendimit ndaj të cilit lejohet ankesa qoftë ndaj aktgjykimit, por nuk mund të konsiderohet shkelje disiplinore. Për më tepër nga shkruesat e lëndës rezulton se ndaj aktgjykimit A.nr.1269/23 të datës 07.03.2024 parashtruesi ka paraqitur ankesë dhe është Gjykata e Apelit e Kosovës që e vlerëson ligjshmërinë e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë. Andaj, për këto arsye Autoriteti Kompetent vlerëson se nuk është shkelur parimi i pavarësisë dhe paanësisë të përcaktuar me dispozitën e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, pasi që të gjitha veprimet e ndërmarra nga gjyqtari i çështjes janë veprime të cilat parashihen me legjislacionin në fuqi.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nuk janë shkelur dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/06/24, me datë 08.04.2024

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë